



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 11
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225
Prishtinë, më 29 prill 2015, në orën 11:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, kryetare e Komisionit, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi, anëtarë.

Mungoi: Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 22.4.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor, para miratimit në parim;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent, para miratimit në parim;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, para miratimit në parim;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më: 22.4. 2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.4 2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor, para miratimit në parim;

Kryetarja – Projektligjet kanë mbërri dhe ne do t'i shqyrtojmë në parim. Këto ligje kanë qenë në procedurë edhe në mandatin e kaluar, por kanë mbet të papërfunduara. Ne në disa prej tyre patëm punuar dhe ju edhe mund t'i krahasoni me ato amendamente që kanë qenë.

Time Kadrijaj – Në mandatin e kaluar patëm punuar në amendamentimin e këtij Projektligji dhe patëm konsultuar edhe ekspertë, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, Ligji mbet pa u miratuar. Tani po e shohim se shumica e amendamenteve të mandatit të kaluar janë përfshi, por prapë do të punojmë me seriozitet që Ligji të jetë sa më i mirë.

Kryetarja – Duhet vlerësuar faktin se vërejtjet që i kemi pasur në mandatin e kaluar në këtë Projektligj janë përfshi. Pra, jemi që Projektligji të procedohet në Kuvend.

Besa Baftiu – Edhe unë e përkrah kalimin në parim të Projektligjit dhe pas miratimit në Kuvend do të punojmë në amendamentim .

Shukrije Bytyçi – Ky Projektligj është i vonuar sepse duke pas parasysh që jemi shtet i dal nga Lufta dhe kemi pas shumë pasoja të luftës, ky projektligj ka qenë i domosdoshëm. E mbështes kalimin në parim të Projektligjit dhe pastaj gjatë amendamentimit në konsultim edhe me ekspertë, do ta plotësojmë Projektligjin.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë :

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për Shëndetin Mendor.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent, para miratimit në parim;

Kryetarja – Edhe ky Projektligj në mandatin e kaluar nuk u përfundua, por tani prapë u rikthye në Kuvend dhe do të punojmë bashkërisht për amendamentimin e tij.

Fadil Beka – Mendoj se Projektligji i plotëson kriteret të kaloj në Kuvend, por gjatë amendamentimit ka nevojë për konsultime më të gjëra me ekspertë, sepse mendoj se duhet të jenë të angazhuar në këtë ligj edhe policia, zjarrfikësit, por edhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Kam përshtypjen se nuk është e sqaruar se kush i pari duhet të jetë në vendin e ngjarjes, pra duhet të jetë ekipi i koordinuar. Gjatë amendamentimit do të punojmë më në detaje.

Kryetarja – Mendoj se patjetër ka nevojë për disa intervenime në ligj sepse në raste kur duhet të intervenohet, në rastet emergjente nga mjeku prezent kushdo qoftë, në ligj thuhet që vetëm ekipet emergjente duhet të intervenojnë. Duhet shikuar praktikën e vendeve tjera, se a duhet dhënë ndihmën e parë edhe ndonjë profesionist tjetër prezent në vendngjarje. Gjithashtu ndoshta duhet të angazhohet edhe Kryqi i Kuq në rastet emergjente.

Fadil Beka – Mendoj se nuk është problemi te trajtimi spitalor, por problemi është derisa pacienti të mbërrij në spital. Efikasiteti i shërbimit emergjent, është shpejtësia nga vendi i ngjarjes deri në qendrën emergjente.

Besa Baftiu – Mundësia më e shpejt e intervenimit në raste emergjente ndoshta është përmes helikopterëve si parashihet edhe në Ligj, dhe mendoj se edhe ministria do t'i sigurojë helikopterët, pasi i ka parapa në Ligj.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë :

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent .

5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, para miratimit në parim;

Kryetarja – Ky Ligj është aprovuar më herët, tani ka ardhur si ligj i ri, a ka ndonjë vërejtje apo mund të procedohet për Kuvend?

Besa Baftiu – Është një Ligj i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës, por ka nevojë për disa ndryshime.

Kryetarja – Mendoj se ligj ndoshta ka mundur ta ketë një emër tjetër, ndoshta si ligj për edukim shëndetësor për nënat. Projektligji ka nevojë për disa amendamente.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë :

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, para miratimit në parim.

6. Të ndryshme.

Shukrije Bytyçi- Desha ta ngrit si çështje mbylljen e Repartit të Kardiokirurgjisë. Në takimin që patëm me ministrin e shëndetësisë dhe drejtorin e SHSKUK-së, nuk e diskutuam këtë sepse patëm një temë tjetër, por përmes mediave e kuptuam se është mbyllur Reparti i Kardiokirurgjisë, nuk e di a keni pas ju ndonjë kontakt për këtë çështje.

Flora Brovina-Jo, nuk kemi pasur.

Besa Baftiu- Ministria ka thënë që e ka prioritet kardiokirurgjinë. Propozoj që ta vizitojmë këtë repart.

Fadil Beka- Mendoj se janë duke shqyrtuar mundësinë të bëjnë marrëveshje me Shqipërinë, që të sjellin kardiokirurgë nga Shqipëria.

Time Kadrijaj- Ne nuk mund ta vizitojmë kardiokirurgjinë sepse është e mbyllur .

Shukrije Bytyçi - Desha ta diskutoj edhe në takimin me ministrin , por kur jemi duke diskutuar në një temë të caktuar, nuk po mundemi me i ngrit të gjitha çështjet. Derisa ne jemi pjesë e këtij komisioni, qytetarët pyesin se edhe sa kohë duhet që të bëhet funksionalizimi i repartit të kardiokirurgjisë.

Fadil Beka- Kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Ne veç mund ta ngrisim si shqetësim sepse po ndodhë. Kaq mund të bëjmë si komision.

Besa Baftiu- Nëse e ka prioritet ministria hapjen e këtij reparti, sa kohë duhet për funksionalizim dhe gjetjen e kuadrit?

Kryetarja- Atëherë le të jetë kjo si pyetje parlamentare e komisionit.

Besa Baftiu -Këtë pyetje e kam bërë por ende nuk e kam dorëzuar.

Fadil Beka- Kur kam qenë unë drejtor e kam bërë një marrëveshje me disa investitorë amerikanë, për ndërtimin e kardiokirurgjisë, në mënyrë që ata të vinë dhe marrin kuadrot e brendshme. Derisa ne t'i bëjmë kuadrot, ata do të ishin këtu. Ne e kemi pasur për obligim vetëm ta gjejmë një vend. Më pas, nuk është marr kush me atë marrëveshje.

Shukrije Bytyçi- Duhet të mësohemi të respektojmë marrëveshjet pa marrë parasysh se kush është drejtor. Realisht ne nuk jemi prokurori, të shkojmë e t'i hulumtojmë të gjitha marrëveshjet.

Fadil Beka- Është dashur të bëhet edhe kardiokirurgjia e fëmijëve, që do të ishte qendër e krejt rajonit. Na mungojnë edhe kuadrot për kardiokirurgji.

Shukrije Bytyçi -Për mua vërtet është ofenduese një specialist që është shkolluar 30 vite ta ketë një pagë 1000 euro. Duhet udhëhequr politikë, që ekspertët tonë me i ndal këtu sepse kur po shkojmë jashtë shtetit për shërim, kjo po na kushton me qindra mijëra euro. Kemi pas përvoja jo të mira në shëndetësi në sektorin privat, prandaj jam për atë që ta forcojmë shëndetësinë në sektorin publik. Nuk po i mbroj interesat personale, por të qytetarëve. Është shqetësuese kur është bërë ajo marrëveshje. Nuk është se po e kundërshtojmë por le të zbatohet praktikisht si në letër.

Fadil Beka-Nuk kemi kuadro të kardiokirurgjisë. Pagesat janë të dobëta dhe ata fitojnë më shumë në sektorin privat.

Kryetarja-Këtë çështje është mirë të diskutohet në një tryezë. Kuadrot nuk formohen aq shpejt.

Fadil Beka - Ministria duhet të vendos për kardiokirurgjinë; a donë ta mbajë apo këtë donë ta bëjë përmes partneritetit publiko-privat. Nëse donë partneritet, i lejohej, por le të funksionon në nivel të shtetit, dhe të subvencionohet nga shteti.

Kryetarja –Mund të shkojmë në një vizitë në ministri dhe të diskutojmë për kardiokirurgjinë.

Time Kadrijaj- Nuk ke çka thotë tash se ministria ngase ajo është dashtë të investojë në kuadro.

Kryetarja- Temë tejet aktuale ndoshta në një takim të ardhshëm e bëjmë një debat me faktorët kyç edhe për kuadrot edhe për çështjet publike-private edhe për marrëveshjet me Shqipërinë, sepse ka disa marrëveshje me Shqipërinë, si ato për sëmundjet e kancerit, sëmundjet kardiokirurgjive, këmbimi i kuadrove edhe disa çështjet tjera.

Besa Baftiu- Paraprakisht të bisedojmë me ministrin, të diskutojmë nëse kanë ndonjë marrëveshje.

Time Kadrijaj- Gjatë vizitës që e kemi pasur mandatin e kaluar në Shqipëri, patëm takime me ministrin dhe me zyrtarë. Ata patën dhënë mendime, që këto reparte dhe trajtimet specifike mos të dyfishohen, por të kenë një shërbim ata, një shërbim ne, derisa t'i funksionalizojmë të gjitha shërbimet për pacientët tanë dhe anasjelltas. Kjo ide veç ka ekzistuar.

Kryetarja -Shume shtete të regjionit, mendoj edhe Serbia e edhe Maqedonia kanë fituar projekte në emër të asaj që i shërbejnë regjionit, edhe Kosovës . Beogradi ka fituar për kardiokirurgji, në sëmundje të kancerit, ka fituar Maqedonia edhe Shqipëria, prandaj kemi të drejtë në marrëveshje ndërshtetërore me shtetet e regjionit, të kërkojmë këmbimin e kuadrove. Por me rastin e lidhjes së marrëveshjeve duhet të kemi shumë kujdes.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA